

Plagosje në Malishevë, viktima dërgohet në QKUK



11/01/2025 09:04

f

t

Një person ka mbetur i plagosur nga arma e zjarrit në një lokal në Malishevë, i cili më pas është dërguar për QKUK për tretman mjekësor. Sipas mjekëve, ai është jashtë rrezikut për jetë.

Ndërkaq, policia ka thënë se ka arrestuar të dyshuarin, i cili ka dorëzuar një armë me gaz me shtatë fishekë.

“Malishevë 10.01.2025 – 03:25. Është raportuar se në një lokal, ka ndodhë një rast plagosje me armë zjarri. Viktima mashkull kosovar ka mbetur i plagosur dhe është dërguar në QKUK për tretman mjekësor. Sipas mjekëve viktima është jashtë rrezikut për jetë. Lidhur me rastin është identifikuar dhe arrestuar i dyshuari mashkull kosovar i cili ka dorëzuar një armë me gaz me shtatë (7) fishekë kal.9mm dhe një gëzhgjë fisheku me gaz e cila armë dyshohet se është përdorur në rast. Lidhur me rastin është bastisur shtëpia e tij, por nuk është gjetur asgjë e dyshimtë. Me vendim të prokurorit kujdestar të dyshuarit, i është caktuar masa e ndalimit policor për 48 orë. Rasti është duke u hetuar”, tha policia në raport

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



January 11, 2025
Zhduket një grua në Ferizaj



January 11, 2025
Moti me borë, policia apel qytetarëve: Kujdes të shtuar në komunikacion



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Gr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information